



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNA AVTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



Nr. prot. 562/1

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
Prishtinë 04.03.2024	
Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit Regulatorna Avtoritet za Usluge Vode Water Services Regulatory Authority	
Nr. i Protokollit, Dëftimit, No.	162/02
Nr. i Dokumentit	D
Nr. i Aktit të Miratimit, Dëftimit, No.	04/03/2024
Prishtinë - PRISTINA - PRISTINA	

ANEKS MARRËVESHJE E BASHKËPUNIMIT

Për realizimin e interesave të përbashkëta të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Autoritetit Rregullator të Shërbimeve të Ujit, që kanë për qëllim avancimin dhe ngritjen e arritjeve profesionale në arsimin e lartë, bashkëpunimit shkencor, arsimor dhe akademik në mes institucioneve, hapjen e mundësive të reja të bashkëpunimit, shkëmbimit të eksperiencave profesionale dhe këshillimit, si dhe angazhimit të studentëve për zhvillimin e praktikës profesionale, arrihet kjo aneks marrëveshje e bashkëpunimit midis:

FAKULTETIT TË INXHINIERISË SË NDËRTIMIT, FIN-UP

dhe

AUTORITETIT RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT, ARRU

Kjo aneks marrëveshje lidhet mbi bazën e marrëveshjes së nënshkruar në mes Universitetit të Prishtinës UP dhe Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit ARRU me nr. protokoli të UP-së, 586 të datës 21.02.2024 dhe nr. protokoli ARRU, 162 të datës 21.02.2024, me qëllim të shkëmbimit të eksperiencave profesionale dhe këshillimit si dhe angazhimit të studentëve të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit në projektet e ARRU-së për zhvillimin e praktikës profesionale. Palët bien dakord të respektojnë qëllimin e kësaj Aneks Marrëveshje të Bashkëpunimit si më poshtë.

Kjo aneks marrëveshje është përpiluar mbi bazën e konsultimeve, diskutimeve dhe angazhimeve konkrete të zhvilluara ndërmjet Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit-FIN dhe Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit-ARRU më qëllim të realizimit të ekspertizave, analizave dhe studimeve të përbashkëta, ngritjen profesionale të studentëve dhe të programeve të studimeve për fushat e Inxhinierisë së Ndërtimit.

Neni 1

Palët

1. Kjo Aneks Marrëveshje e Bashkëpunimit (këtu e tutje: Aneks Marrëveshja) lidhet ndërmjet Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU).

2. Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit -FIN, me seli në rr. "Agim Ramadani", Ndërtesa e Fakulteteve Teknike, 10000 Prishtinë-Republika e Kosovës, përfaqësuar nga Dekani i Fakultetit Prof.Ass.Dr. Florim Grajçevci.

3. Autoriteti Rregullator për Shërbimet të Ujit -ARRU, me seli në Rr. Ali Pashë Tepelena, nr. 01 Prishtinë, Kosovë, përfaqësuar nga Drejtore MSc. Hajrije Morina.

Neni 2

Fushëveprimi

1. Kjo Aneks Marrëveshje vendos natyrën dhe nivelin e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet FIN-it dhe ARRU-së.
2. Dispozitat e këtij aneksi, si dhe kërkesat tjera ligjore duhet respektuar nga të dy palët nënshkruese.

Neni 3

Zotimet dhe detyrimet ndërmjet palëve

1. FIN merr përsipër që të përcaktoj ekspertët për hartimin e ekspertizave profesionale, këshillimeve sipas nevojave dhe kërkesave të ARRU-së, si dhe për angazhimin e studentëve nga programet e studimeve të FIN-së për zhvillimin e praktikës profesionale në projektet e ARRU-së.
2. FIN siguron që grupi apo individët e përzgjedhur të kenë një bartës, i cili do të mbikëqyrë, shpërndajë dhe organizojë detyrat e grupit/ individëve duke qenë përgjegjës si dhe i njëjti do të prezantohet si përfaqësues i grupit të FIN-së me personat e autorizuar të Autoritetit Rregullator për Shërbimet të Ujit.
3. FIN, me kërkesë të ARRU-së, siguron në raste të nevojshme edhe ekspertë nga stafi akademik që mund të shtohet në funksion të kërkesave të veçanta lidhur me bashkëpunimin.
4. ARRU merr përsipër të lejoj qasjen në hapësirat e saj, të përkrahë grupet e ekspertëve dhe studentëve me qëllim të realizimit të praktikave profesionale, ekzaminimeve të ndryshme të nevojshme për hartimin e ekspertizave, analizave dhe studimeve të përbashkëta për ngritjen profesionale të studentëve.
5. ARRU angazhon njërin nga zyrtarët që të jetë Koordinator dhe bashkëpunues me grupin e punës të FIN-së me qëllim të harmonizimit të kërkesave si dhe të kushteve tjera teknike të domosdoshme.

Neni 4

Puna e grupit të FIN-së

1. Grupi punues i FIN vetorganizohet në koordinim me Drejtorin dhe Koordinatorin e Autoritetit Rregullator për Shërbimet të Ujit lidhur me kohën dhe vizitat e planifikuara në terren.
2. Ditët e punës, orët e të ngjashme i propozon grupi punues nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit në konsultim me Koordinatorin e Autoritetit Rregullator për Shërbimet të Ujit.

3. Në bashkëpunim me Autoritetit Rregullator për Shërbimin e Ujit, grupi përcakton dhe radhitë veprimet e domosdoshme paraprake për realizimin e projekteve apo praktikave profesionale të studentëve.

Neni 5

Ndryshimi dhe përfundimi

1. Ky aneks mund të ndryshohet vetëm me shkrim, e në asnjë rast apo rrethanë në formë tjetër.
2. Ky aneks mund të shkëputet nga secila palë me kushtin që të njoftoj palën tjetër me shkrim tridhjetë (30) ditë më herët.

Neni 6

Vijimi i praktikës

Punën praktike në ARRU mund ta vijnë vetëm studentët e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, sipas listës të miratuar nga Dekani i Fakultetit. Angazhimi i studentëve gjatë kryerjes së praktikës profesionale është pa kompensim. Orari i kryerjes së praktikës profesionale të studentëve duhet të harmonizohet me orarin zyrtar të punës së zyrtarëve civil.

Neni 7

Mirësjellja

Studentët që vijnë praktikën profesionale i nënshtrohen dhe duhet t'i përmbahen përshtatshëmrisht dispozitave të Rregullores (QRK) - Nr. 04/2015 për Kodin e mirësjelljes në shërbimin civil të Republikës së Kosovës.

Neni 8

Standardi i punës së praktikantit

Studentët që vijnë praktikën profesionale obligohet ti kryejnë shërbimet sipas standardeve më të larta të etikës profesionale, ti ruajë dhe përdorë me kujdes të gjitha pajisjet me të cilat punon. Studentët, përveç për analiza dhe hulumtime, duhet të kenë kujdes të mos keqpërdorin të dhënat dhe informacionet që janë në përgjegjësi të ARRU-së.

Neni 9

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët do të përpiqen të zgjidhin në mënyrën më të përshtatshme çdo mosmarrëveshje që buron nga ky Aneks Marrëveshje e Bashkëpunimit.

Neni 10

Hyrja në Fuqi

Ky Aneks Marrëveshje Bashkëpunimi do të hyjë në fuqi me nënshkrimin e Palëve. Në praninë e përfaqësuesve të autorizuar të Palëve, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje në dy (2) kopje origjinale në gjuhën shqipe, duke qenë të dyja kopjet me cilësinë e dokumenteve autentike, në datën e deklaruar më poshtë.

Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit


Prof. Ass. Dr. Florim Grajçevci

Dekan



Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit


MSc. Hajrije Morina

Drejtor

